



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.63

Prishtinë, më 26.9.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviç, Shpejtim Bulliqi, Bekim Haxhiu, Mufera Shinik, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësuesit e MASHT-it, KDI dhe media.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19.9.2016;
3. Raportim i ministrit të Arsimit lidhur me fillimin e vitit shkollor, si dhe pajisjen me tekste shkollore;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.9.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 19.9.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit të Arsimit lidhur me fillimin e vitit shkollor, si dhe pajisjen me tekste shkollore

Nait Hasani, tha se kërkesë e anëtarëve të Komisionit nga mbledhja e kaluar, ka qenë që të ftohet ministri, që të raportojë për fillimin e vitit të ri shkollor 2016/2017 dhe për çështjen e teksteve shkollore. Komisioni, në mënyrë të vazhdueshme, ka mbikëqyrë fushën e arsimit, në mënyrën më të mirë të mundshme, me kapacitet të mjaftueshëm.

Arsim Bajrami, ministër, tha se viti i ri shkollor ka filluar mjaft i përgatitur, ku edhe gjatë kohës së pushimeve verore është punuar intensivisht në segmente të ndryshme, sa i përket fushës së arsimit. Ai tha se numri i nxënësve në arsimin parauniversitar ka arritur në 260 mijë, ndërsa numri i mësimdhënësve është afër 24 mijë. Po ashtu, tha se ka pasur përparime në implementimin e strategjisë për ngritjen e cilësisë, ku më shumë se 20% e shkollave kanë koordinatorët për cilësi, pra një institucion i ri, ku do të kujdeset për performancën e shkollës, monitorimin e cilësisë mësimore. Rishikimi i teksteve që është bërë për herë të parë nga zëvendësministrja Statovci, ku së bashku me një ekip të ekspertëve ka udhëhequr një komision për tre muaj. Kanë punuar dhe rishikuar 86 tekste mësimore, nga klasa e parë deri në klasën e 9-të, ku edhe janë korrigjuar dhe ndryshuar në shkallë prej 40%, duke marrë për bazë gabimet drejtshkrimore apo edhe profesionale. Ai tha se prioritet themelor do të jetë implementimi i strategjisë për ngritjen e cilësisë mësimore, ku synim i këtij prioriteti është standardizimi kombëtar. Nxënësit duhet të vlerësohen me standard unik, duke filluar nga sistemi i notimit, deri te sistemi i akumulimit të notës.

Nait Hasani, ngriti çështjen e nostrifikimit të diplomave, si dhe çështjen e ligjit, të njohë stazhin e punës së mësimdhënësve, ku sindikata ka paralajmëruar për disa angazhime të veta, andaj kërkohet ky ligj që është në Ministrinë e Financave, të kthehet të paktën pjesa buxhetore dhe t'u japim mirënjohje nga Kuvendi për punën e tyre në vitet 1990-1999. Kolizioni i ligjeve për shërbyes civilë, Ligji i arsimit në komuna, Ligji i arsimit parauniversitar dhe Ligji për vetëqeverisje lokale, kanë mjaft implikime të drejtpërdrejta në fushën e arsimit.

Salih Morina, tha se mungesa e buxhetit për vitin e ri shkollor dhe vështirësia për sigurimin e mjeteve shkollore, kanë qenë shkak që në disa vende, në mungesë të teksteve, prindërit të detyrohen t'ua blejnë fëmijëve të tyre tekstet shkollore. Cilat janë masat që do të ndërmarren Ministria e Arsimit, sa i përket regjistrimit të studentëve nëpër kolegje private dhe a do të ketë studentë që do të regjistrohen jashtë afatit të paraparë nga Ministria e Arsimit? Çështja tjetër ka të bëjë me sistemimin e pedagogëve, a është në përgjegjësi të Ministrisë së Arsimit apo përgjegjësi komunale?

Ismajl Kurteshi, tha se raporti që është sjellë nga Ministria është dashur shumë më herët, sepse sot është pothuajse e pamundur leximi i këtij raporti. Ngriti çështjen e konkursit për regjistrimin e nxënësve në gjimnaze dhe shkolla tjera, në shkollën e bujqësisë dhe të mjekësisë në Komunën e Gjilanit, që janë jashtë funksionit. Një çështje tjetër që është në raportin e Ministrisë, thuhet se me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, në takimin e radhës të Komisionit për Edukim dhe është diskutuar që në komisionet për rajone, të punohet me aktivitete të shtuara për parandalim të dukurive negative në shkolla. Një problem tjetër qëndron në faktin se mësimi ka filluar që 26 ditë dhe me çfarë baze ligjore është shtyrë mësimi, pa pasur kurrfarë të drejte për këtë vendim, pasi që nuk ka qenë ndonjë gjendje e jashtëzakonshme dhe konsiderohet shkelje e ligjit. Në Komunën e Gjakovës, ende nuk bëhet transportimi i nxënësve, të cilët e kanë të garantuar me ligj këtë transport. Ka probleme të ngjashme të kësaj natyre edhe në Komunën e Dardanës, edhe në komuna tjera, ndërsa nuk ka asnjë reagim nga Ministria që të ndërhyjë në këto parregullsi, pasi që humbja e mësimit për një muaj është mjaft brengosëse. Papërgjegjësi tjetër nga ana e Ministrisë së Arsimit është edhe vonesa e pajisjeve me mjete shkollore, si dhe moslejimi i shpërndarjes së librave të vjetër, pra të viteve të kaluara. Mungesa e ditarëve nëpër shkolla ka pamundësuar vazhdimin e procesit mësimor. Kërkohet që para Komisionit të tregohet për dedikimin e librave në Luginën e Preshevës, që janë premtuar vitin e kaluar nga ana e Ministrisë, premtim ky që nuk është realizuar ende. A ka ndonjë përpjekje që këto tekste të arrijnë në

Luginën e Preshevës? Vitin e kaluar keni deklaruar se tekstet nga Serbia nuk do të hyjnë në Kosovë, në qoftë se nuk do të lejohen tekstet në Luginën e Preshevës. Gjatë muajit gusht nuk janë shpallur konkurset dhe nuk janë kualifikuar mësimdhënësit, siç është përmendur nga ana juaj. Në shumë shkolla po përsëriten konkurset për drejtorë, për arsye politike, pasi që nuk po arrijnë t'i kenë personat e tyre në krye të shkollave. Nga 1200 shkolla, në tërë vendin, janë vetëm 37 psikologë, problem që është mjaft serioz. Si ministër, keni deklaruar se nuk jeni ministër i prerjes së shiritave, ndërsa pak më parë na ftuat si komision në prerjen e shiritit. Është paralajmëruar organizmi i testeve për mësimdhënësit, mirëpo Sindikata e Arsimit e ka kundërshtuar këtë. A keni planifikuar në orientimin e planifikimit të nxënësve dhe studentëve, pasi që siç po shihet, në disa drejtime, është një numër i madh i nxënësve dhe studentëve që përfundojnë fakultetin dhe mbesin të papunë, ndërsa ka fusha të caktuara, sidomos në pjesën e zejtarisë, ku ka mungesë të kuadrit. Çka po ndërmerr Ministria për zhvillimin e mësimin praktik në shkolla profesionale, pasi që, siç dihet, në shkolla profesionale nuk zhvillohet praktika ose ka vetëm mësim formalisht, sidomos ata studentë që e përfundojnë shkollën profesionale, nuk bëhen ekspertë ose mjeshtër të fushës përkatëse.

Çka është ndërmarrë në pengimin e mbajtjeve të kurseve të ndryshme të palicencuara?

Teuta Haxhiu, tha se ka shumë çështje që duhet përmendur, mirëpo është mjaft me rëndësi të përmendet sigurimi i teksteve dhe ndarja e teksteve që nga viti 2008-2009. Ky buxhet ka qenë 3 milionë dhe ka shkuar vetëm duke u trefishuar. Numri i nxënësve ka rënë, mirëpo ka ende mjaft probleme për ndarjen e buxhetit për kit vit të ri shkollor. Jo më shumë se 5% e teksteve të përdorura nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të, duke përjashtuar klasën e parë deri në klasën e 5-të, shumë prej librave plotësohen dhe janë të papërdorshëm. Edhe pse me kërkesën time dhe të disa mësimdhënësve janë hapur ato depo të librave të përdorura vite më parë, ato asnjëherë nuk janë përdorur. Sa i përket rishikimit të teksteve, cilat tekste më saktësisht janë rishikuar?

Për mësimdhënësit e viteve të 90-ta është fyese për pensionin që e marrin prej 65 euro për punën 40 vjeçare, ndërsa ata që nuk kanë punuar fare paguhën 75 euro. Plan-programet serbe nëpër shkolla dhe u vijnë tekste nga Serbia, të cilat nuk e përfillin aspak Ministrinë e Arsimit.

Pavarësisht asaj që ministri e kishte përmendur, rregullimin e kontratave në muajin qershor për një fillim sa më të mbarë shkollor, ende ka probleme në shumicën e shkollave me staf. Përmendja e kurrikulës dhe çështja e mësimin nëpër shkolla, ku janë dhënë miliona euro për trajnime të mësimdhënësve. Sa keni njohuri ju si ministër për aplikimin e këtyre njohurive nga

ana e mësimdhënësve? Një problem tjetër është se nuk është e drejtë të bëhet ndarja e buxhetit të teksteve shkollore për kokë nxënësi, njëjtë sikurse në qytet, ashtu dhe në fshatra të thella në Komunën e Gjakovës, Pejës etj. Ndarja e buxhetit për kokë nxënësi ka lënë shumë mësimdhënës jashtë procesit mësimor dhe sot komunat kanë këto probleme, sepse nuk mund të hapin konkurs, të marrin kuadër të ri. Me Ligjin e arsimit të lartë, nuk lejohet mësimdhënësi të punojë të njëjtën kohë edhe në institucione publike dhe në ato private, ndërsa me vendim që është bërë nga ministri, 305 mësimdhënës punojnë të njëjtën kohë edhe në institucione publike, po ashtu edhe private.

Mufera Shinik, tha se problemi me nostrifikimin e diplomave është problem që kërkon zgjidhje të menjëhershme. Kërkoi sqarim lidhur testimin e mësimdhënësve, si dhe me çështjen e mësimdhënësve, të cilët për shkak të gjendjes shëndetësore nuk mund të mbajnë mësim. Sa i përket fletoreve të punës në gjuhën turke, ajo tha se ato duhet të korrigjohen, ndërsa tekstet shkollore në gjuhën turke janë nga klasa e parë deri në klasën e 9-të.

Shukrije Bytyçi, tha se ministri ka angazhuar familjarë, që i kanë ndihmuar për grumbullimin e votave për zgjedhjet e përgjithshme. Personi në fjalë ka punuar me kontratë në vepër në Departamentin e Shkencës, tani është emëruar si udhëheqës divizioni dhe pjesë e Komisionit për pranimin e diplomave në gjuhën serbe. Në licencimet e institucioneve parauniversitare, kolegjeve private, gjithmonë janë përfshirë stafi politik dhe inspektorë. Kërkoj sqarim lidhur me programet e paakredituara në Universitetin e Prizrenit dhe shkeljet që janë bërë, duke pranuar staf punues, me diploma të panostrifikuara. Sa i përket sigurimit të literaturës për fëmijët e verbër, si ministri, nuk keni punuar fare në këtë drejtim. Institucioni për Arsim dhe Aftësim ka paguar një vit mësimdhënësit në Komunën e Malishevës, ku përkundrazi ky institucion ka nxitur konflikt në mes njerëzve.

Shpejtëm Bulliqi, në diskutimin e tij foli për problemet me të cilat ballafaqohet një numër i madh i shkollave, ku numri i nxënësve në ciklin e ulët kalon numrin e nxënësve të paraparë për atë klasë dhe procesi mësimor vështirësohet, si nga ana e mësuesit, ashtu edhe për nxënësit. Kërkoi sqarim se a është bërë ndonjë analizë për gjithsej numrin e këtyre paraleleve në të gjithë Kosovën dhe sa njerëz duhet të punësohen në mënyre të zvogëlimit të numrit të nxënësve në paralele. Problemi tjetër është pajisja me ditarë nëpër shkolla, ku procesi mësimor për këto ditë është zhvilluar pa ditar.

Bekim Haxhiu, fillimisht shtroi çështjen e rishikimit të teksteve shkollore, ku ka një mori diskrecionesh në libra të historisë. Studentet e Kosovës, të cilët investojnë në shkollimin e tyre në Shqipëri, pas përfundimit të studimeve, ata nuk pajisen me diploma, pas një viti e gjysme të përfundimit të universitetit.

Edhe pse kemi bërë mjaft përpjekje, në lidhje me zgjidhjen e këtij problemi, mirëpo kjo neglizhencë vazhdon në Universitetin e Tiranës, përkundër këtij bashkëpunimi. Kërkoj një angazhim nga ana juaj, që këto probleme të zgjidhen në Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë, pasi që po u pamundësohet aplikimi i studentëve për punë.

Arsim Bajrami, tha se të do të mundohet që asnjë mësimdhënës të mos largohet, për shkak të zvogëlimit të klasave apo zvogëlimit të numrit të nxënësve, sepse nga grandit specifik që iu ndahet komunave, paraqitet numri aktual për mësimdhënës.

Ministria do të ndërmarrë masa të menjëhershme për shtimin e stafit të psikologëve dhe pedagogëve, pasi që, siç dihet, është një numër mjaft i vogël i tyre. Nostrifikimi i diplomave është një problem permanent, por megjithatë Ministria ka arritur të zvogëlojë pritjen dhe sistemi po funksionon mjaft mirë. Sa i përket shifrave të ndarjes së buxhetit për tekste shkollore, gjatë dy viteve të fundit, është zvogëluar dukshëm.

Ndërsa, tek ndarja e teksteve të Luginës së Preshevës, të gjithë jemi munduar në këtë çështje, duke mbajtur debate në Kuvend dhe duke krijuar rezoluta, dhe në bazë të konkluzioneve dhe kërkesave, ato libra kanë pasur për qëllim të mbërrijnë në shtator, dhe arsyeja se pse nuk kanë arritur këto tekste mësimore është se qeveria serbe nuk i dëshiron fare.

Ministria e Arsimit do të vendosë një sistem të vlerësimit të performancës, pasi që është kërkesë e të gjithë neve në ngritjen e procesit të mësimdhënies.

Anila Statovci - Demaj, tha se rishikimi i teksteve shkollore ka qenë proces mjaft serioz. Tekstet shkollore kanë nevojë për rishikim. Dilema më e madhe qëndron në problemin e peshës të çantave shkollore për fëmijët. Në qoftë se do të ndahej një libër në dy pjesë, atëherë do të kemi rritje të buxhetit për tekste shkollore, andaj apelohej që ky problem të zgjidhet, duke pasur bashkëpunim në mes të mësimdhënësve dhe fëmijëve, gjithmonë duke përfshirë edhe prindërit.

4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës

Kjo pikë e rendit të ditës, shtyhet për në mbledhjen e radhës, pas marrjes së raportit me shkrim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

5. Të ndryshme

Përfaqësuesit e GIZ-it paraqitën një pyetësor para Komisionit për Arsim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani